



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 77, datë 04.03.2021**

**PËR**  
**FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KRITEREVE**  
**LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN E POSAÇME TË**  
**APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR, PËR POZICIONIN E**  
**LIRË TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 30, DATË 25.01.2021, TË KËSHILLIT TË**  
**LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 135, pika 4 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronjat “a” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronjat “ç” dhe “ë”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 48, pika 7, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni A, pika 1, shkronja “c” dhe pika 2, të Vendimit të tij nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pas shortit të hedhur,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 30, datë 25.01.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë:

1. Për kandidatin z. {...} - relatore znj. Marçela Shehu.

3. Për kandidatin z. {...}, i cili ka kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, procedura e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që është në proces e sipër për këto kandidime, është e vlefshme edhe për kandidimin e tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe

Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 30, datë 25.01.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**